Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke
Ministry of Education and Science

Datë: 05.11.2026

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, duke u bazuar në nenin 2 të Marrëveshjes së Grantit TF0C3867-XK, të nënshkruar më 28 qershor 2024 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore dhe në vendimin nr. 01B-246 të datës 23.12.2024, bën rihapjen e:

THIRRJES PËR REGJISTRIMIN E INSTITUCIONEVE TË EDUKIMIT NË FËMIJËRINË E HERSHME NË PROGRAMIN E KUPONËVE NË KOMUNAT- GJAKOVË, KLINË, VITI, GJILAN, SUHAREKË, PRIZREN, OBILIQ DHE PODUJEVË

Me qëllim të sigurimit të përfshirjes së barabartë gjeografike dhe mundësisë së qasjes së fëmijëve nga familjet përfituese të Skemës së Asistencës Sociale (SAS), Ministria e Arsimit dhe Shkencës, po mundëson një afat shtesë për regjistrimin e institucioneve të edukimit në fëmijërinë e hershme në komunat- Gjakovë, Klinë, Viti, Gjilan, Suharekë, Prizren, Obiliq dhe Podujevës. Kjo rihapje e thirrjes vjen pas përfundimit të afatit të aplikimit të institucioneve në nivel vendi.

Përmes Programit të Kuponëve, MASH do të rimbursojë institucionet pjesëmarrëse që ofrojnë shërbime të edukimit në fëmijërinë e hershme për fëmijët përfitues, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në Udhëzuesin e Programit. Programi synon të rrisë pjesëmarrjen e fëmijëve nga familjet përfituese të SAS-it në edukimin e hershëm dhe të mbështesë zhvillimin e tyre të barabartë që në fazat e para të arsimit.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Institucionet parashkollore private;
- Institucionet parashkollore në partneritet publiko-privat.

Kriteret për regjistrim në program:

Për t'u regjistruar në Programin e Kuponëve, institucionet aplikuese duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Të jenë të licencuara nga MASH për ofrimin e shërbimeve të edukimit në fëmijërinë e hershme;
- Të kenë së paku një vend të lirë për pranimin e fëmijëve përfitues të programit.

Shpenzimet që mbulohen nga programi:

- Pagesa mujore për edukimin në fëmijërinë e hershme deri në 150 euro për fëmijë në muaj, varësisht nga komuna dhe çmimi i tregut;
- Pagesa e transportit të fëmijës për institucionet që ofrojnë këtë shërbim, kur plotësohen kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Udhëzuesin e Programit. Shuma e rimbursimit përcaktohet nga Komisioni për vlerësimin e aplikimeve për Programin e Kuponëve, në varësi të komunës përkatëse dhe distancës rrugore.

Institucionet që ofrojnë transport duhet të përmbushin kërkesat e Udhëzuesit për sigurinë e fëmijëve, përshtatshmërinë e automjeteve dhe shoqërimin gjatë udhëtimit.

Aplikimi bëhet vetëm online, përmes platformës e-Kosova, në shërbimin: Arsimi – Regjistrimi i institucioneve parashkollore private në Programin e Kuponëve.

Vegëza për aplikim: https://ekosova.rks-gov.net/597

Institucionet që tashmë janë pjesë e Programit të Kuponëve dhe nuk kanë aplikuar gjatë afatit të mëparshëm duhet të aplikojnë për të përditësuar të dhënat dhe për të deklaruar vendet shtesë të lira. Në deklarimin e vendeve të lira duhet të përfshihen vetëm kapacitetet shtesë, përtej vendeve të zëna nga fëmijët që aktualisht përfitojnë nga programi.

Institucionet që kanë aplikuar gjatë periudhës 19 tetor - 2 nëntor 2026 nuk kanë nevojë të riaplikojnë.

Afati për regjistrim

Regjistrimi është i hapur nga data 5 nëntor dhe përfundon me 15 nëntor 2026.

Divizioni për arsimin privat parauniversitar në MASH do të vlerësojë aplikimet në bazë të kritereve të përcaktuara.

Për më shumë informata, mund të kontaktoni në:

- Tel: 038 200 65048
- E-mail: programiikuponave@rks-gov.net